



Demokracia në Veprim: Trendet e parafushatës dhe respektimi i standardeve

Periudha: 16 nëntor 2024 – 10 janar 2025

Zgjedhjet parlamentare 2025

Hyrje

Ky është vlerësimi i dytë me radhë i koalicionit Demokracia në Veprim mbi trendet e parafushatës për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025. Ky vlerësim kryesisht fokusohet në atë se sa i kanë zbatuar subjektet politike standardet themelore për fushatë konkurruese, të barabartë, transparente dhe gjithëpërfshirëse. Në analizë po ashtu trajtohen elemente të menaxhimit të operacioneve të ndryshme zgjedhore nga trupat menaxhuese zgjedhore, siç është procedura e certifikimit të kandidatëve dhe subjekteve politike për pjesëmarrje në garë, certifikimi i listës së votuesve, informimi i votuesve dhe votimi jashtë vendit.

Për herë të parë përmbledhen edhe gjetje preliminare mbi shpenzimet financiare që subjektet politike kanë bërë në fushatat e tyre online përmes sponsorizimeve në platformat e rrjeteve sociale (Meta) disa javë para fillimit të fushatës zyrtare zgjedhore, që fillon më 11 Janar 2025.

Po ashtu janë analizuar trendet sa i përket mbulueshmërisë mediale të aktiviteteve zgjedhore të subjekteve politike dhe diskursi në rrjetet sociale, me theks komentet me përmbajtje urrejtëse për kandidatët e subjekteve politike për kryeministra, respektivisht kandidatet gra.

Në fund, ofrohen rekomandime konkrete për të gjithë hisedarët në zgjedhje në mënyrë që të nxitet zbatim më i mirë i kodit të sjelljes nga subjektet politike gjatë fushatës dhe të respektohen standardet që garantojnë fushatë konkurruese, të barabartë dhe transparente.

Gara e barabartë zgjedhore

- ***Kandidatët dhe partitë duhet të kenë mundësi reale për të konkurruar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë.***
- ***Nuk duhet të ketë pengesa artificiale për regjistrimin e kandidatëve apo partive.***

Është një standard themelor për garantimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Ai siguron që të gjitha partitë dhe kandidatët të kenë mundësi të barabarta për t'u regjistruar dhe për të marrë pjesë në proceset zgjedhore, duke respektuar kriteret ligjore dhe duke shmangur diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike, gjinore, fetare ose politike.

Në praktikë, ky standard u vu në pikëpyetje gjatë rastit të moscertifikimit të Listës Serbe nga KQZ-ja. Ky vendim, i marrë në kundërshtim me rekomandimin e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike, e cila kishte konstatuar se subjekti i përmbushte kriteret e nevojshme, nxiti kritika për ndërhyrje të mundshme politike në një proces që duhet të udhëhiqet nga profesionalizmi dhe ligji. Vendimi i mëvonshëm i PZAP-së, por dhe ai i Gjykatës Supreme për certifikimin e këtij subjekti jo vetëm që korrigjoi një gabim procedural, por tregoi gjithashtu mungesën e profesionalizmit në vendimmarrjen e KQZ-së.

Megjithatë, në përfundim të procesit dhe brenda dinamikës dhe afateve të parapara, të gjithë kandidatët dhe subjektet politike që i plotësuan kriteret ligjore patën mundësinë që certifikohen dhe tani të jenë pjesë e garës në zgjedhje. Kjo siguroi një proces gjithëpërfshirës, ku nga nesër mund të jenë pjesë e garës zgjedhore 28 subjekte politike dhe 1,280 kandidatë, duke përmbushur në fund standardet vendore dhe ndërkombëtare.

Nga nesër, në zgjedhje marrin pjesë 28 subjekte politike, të organizuara në 20 parti politike, 5 koalicione parazgjedhore, 2 iniciativa qytetare, 1 kandidat i pavarur, me gjithsej 1,280 kandidatë. Përveç partive politike parlamentare, tre prej tyre garojnë individualisht, siç janë VV, PDK dhe LDK, ndërsa AAK ka hyrë në koalicion me një subjekt politik jo-parlamentar dhe dy iniciativë qytetare (AAK – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma – Nisma Socialdemokrate, Lista Konservatore, Forumi intelektual – E – 30). Këto katër subjekte kanë shfrytëzuar të drejtën ligjore për të pasur nga 110 kandidatë në listat e tyre. Nga numri i përgjithshëm i subjekteve politike, garojnë 8 subjekte politike shqiptare, 6 serbe, 6 rome, ashkali dhe egjiptase, 4 boshnjake, 3 turke dhe 1 gorane.

Risia këtë vit, është pjesëmarrja e një kandidati të pavarur, i cili garon si i vetëm në këto zgjedhje. Në përputhje me kornizën ligjore, kandidati i pavarur do të duhet të përmbushë pragun zgjedhor prej 5% për të siguruar një ulëse në parlament.

Për sa i përket certifikimit të kandidatëve, subjektet politike përmes ndryshimeve ligjore të vitit 2023, ishin siguruar që të ulin kriteret e përshtatshmërisë juridike, duke rezultuar me lista, në dukje „të pastra“ të kandidatëve, ndonëse në mesin e 1,280 kandidatëve kemi të tillë që janë në procese gjyqësore të ndjekjes penale për vepra të caktuara, përfshirë edhe ato korruptive.

Përdorimi i Burimeve Shtetërore

- *Parandalimi i abuzimeve me fondet publike dhe pozitat zyrtare për qëllime elektorale.*

Përdorimi i burimeve publike për qëllime elektorale mbetet një çështje kritike gjatë periudhave zgjedhore. Aktualisht, janë vërejtur disa raste që ngrenë shqetësime mbi integritetin e garës zgjedhore dhe barazinë midis subjekteve politike.

Vendimi i 22 dhjetorit i qeverisë për të shpërndarë nga 100 euro për rreth 700,000 qytetarë, përfshirë 400 mijë fëmijë dhe 300 mijë kategori tjera sociale (pensionistët, dhe skemat tjera sociale), si dhuratë për festat e fundvitit – që ka prekur pothuajse secilën familje – ka ngjallur diskutime nëse një masë e tillë mund të ketë ndikuar tek elektorati në prag të zgjedhjeve. Po ashtu, ceremonia e ndarjes së "kartelave" të punës për 220 të punësuar në KEK, ku kryeministri Albin Kurti mori pjesë personalisht për t'i dorëzuar, shihet si një veprim që mund të interpretohet si përdorim i burimeve shtetërore për qëllime partiake.

Në nivelet komunale dhe qendrore, janë raportuar gjithashtu raste të prerjeve të shiritave dhe promovimeve të projekteve të përfunduara, si ajo e kandidatit të PDK në Mitrovicë, apo kandidatit të LDK në Lipjan, të cilat duket se janë planifikuar qëllimisht për t'u zhvilluar pranë periudhës së fushatës. Këto veprime krijojnë një perceptim të përpjekjeve për të ndikuar votuesit përmes burimeve publike dhe vendosin në pikëpyetje barazinë e garës elektorale.

Sipas praktikave dhe standardeve ndërkombëtare, përdorimi i burimeve publike për qëllime elektorale përbën një shkelje të standardeve të barazisë dhe ndershmërisë në procesin zgjedhor. Ky vendim, i marrë afër zgjedhjeve, mund të interpretohet si një përpjekje për të ndikuar në vullnetin e qytetarëve, duke rrezikuar ndarjen e qartë midis funksioneve qeveritare dhe fushatës elektorale. DnV nënvizon rëndësinë e ndarjes së funksioneve publike nga fushata politike dhe bën thirrje për një kontroll më të mirë mbi përdorimin e burimeve publike gjatë periudhës zgjedhore.

Liria e Fjalës dhe Grumbullimit

- *Kandidatët, partitë dhe qytetarët duhet të jenë të lirë të shprehin mendimet e tyre dhe të organizojnë takime politike pa pengesa.*
- *Duhet të sigurohet që nuk ka kërcënime, dhunë apo frikësim ndaj kandidatëve, vullnetarëve apo votuesve.*

Një nga standardet kyçe për një proces zgjedhor demokratik është garantimi i lirisë së fjalës dhe të drejtës për mbledhje të lirë. Kjo përfshin lirinë e kandidatëve, partive dhe qytetarëve për të shprehur mendimet e tyre dhe për të organizuar takime politike pa pengesa apo ndërhyrje. Gjithashtu, është e rëndësishme që të mos ketë kërcënime, dhunë apo frikësim ndaj kandidatëve, vullnetarëve apo votuesve.

Gjatë kësaj periudhe, ky standard vlerësohet se është përmbushur në masë të konsiderueshme. Nuk është raportuar asnjë pengesë në organizimin e takimeve politike, e aq më pak raste të kërcënimeve apo pengimeve ndaj kandidatëve ose subjekteve zgjedhore. Partitë politike dhe kandidatët kanë zgjedhur një

sërë metodash për të angazhuar qytetarët, duke përfshirë takime masive në ambiente të mëdha, takime derë më derë apo në oda, si dhe takime specifike me grupe të targetuara si diaspora, gratë dhe përfaqësues të sektorit të biznesit.

Pas certifikimit të partive dhe kandidatëve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, fushata zgjedhore ka njohur një intensifikim të dukshëm, veçanërisht në aspektin e komunikimit në rrjetet sociale, ku janë publikuar qindra postime nga subjektet politike; ndërsa nëse llogariten edhe postimet e kandidatëve, arrijmë tek shifra prej mbi një mijë postimesh.

Këto aktivitete kanë treguar një liri të mjaftueshme për subjektet politike për të shprehur qëndrimet dhe për të prezantuar programet e tyre para publikut. Gjithashtu, pjesëmarrja aktive në diasporë ka reflektuar qasjen gjithëpërfshirëse të disa subjekteve. Deri më tani, janë publikuar tre programe zgjedhore nga partitë politike, të cilat janë prezantuar përmes aktiviteteve publike dhe mediave.

Mesazhet politike të përdorura nga subjektet kanë qenë kryesisht programore, duke trajtuar tema të rëndësishme si: Ekonomia; Çështjet sociale; si dhe Mbrojtja e siguria.

Shumica e partive politike kanë publikuar platformat e tyre politike në kohë dhe kanë bazuar aktivitetet e tyre kryesisht në aspekte programore. Megjithatë, partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, është përjashtimi i vetëm në mesin e partive të mëdha parlamentare, pasi nuk e ka bërë ende publike platformën e saj politike, edhe sot, kur jemi një ditë përpara nisjes zyrtare të fushatës.

Në përgjithësi, situata deri tani sugjeron se parimet e lirisë së fjalës dhe mbledhjes janë respektuar, duke krijuar kushte të favorshme për një proces të hapur dhe demokratik zgjedhor.

Liria e Shprehjes dhe Informimit

- *Garantimi që media ka mundësi të barabarta për të mbuluar të gjitha partitë dhe kandidatët pa ndërhyrje apo censurë.*
- *Vlerësimi i hapësirës që u jepet partive në media dhe shmangia e mbulimit të njëanshëm.*
- *Liria e qytetarëve për të marrë informacion të paanshëm dhe për të shprehur pikëpamjet e tyre pa frikë nga represioni.*

Liria e shprehjes dhe garantimi i qasjes së barabartë në informim janë thelbësore për një proces zgjedhor demokratik. Në këtë drejtim, mediat kanë luajtur një rol të rëndësishëm duke i dhënë një dinamikë dhe gjallëri aktiviteteve politike gjatë fushatës zgjedhore. Në mënyrë të përgjithshme, hapësirat mediale deri tani kanë pasur një qasje gjithëpërfshirëse, duke u siguruar që qytetarët të marrin informacion të detajuar për procedurat zgjedhore, numrat, vendimet dhe zhvillimet më të rëndësishme.

Mediat kryesore, veçanërisht televizionet dhe portalet online, kanë ofruar transmetime në prime time të debatesh analitike, përballjeve mes kandidatëve dhe intervistave me liderë politikë. Kjo ka krijuar një hapësirë të gjerë për informim dhe pjesëmarrje. Gjithashtu, disa media private kanë publikuar kalendarë

për transmetimin falas të spoteve zgjedhore të partive, duke përmbushur detyrimet e tyre ligjore dhe duke kontribuar në një qasje të barabartë për të gjithë akterët politikë.

Megjithatë, një aspekt që vlen të përmendet është mungesa deri tani e debateve të drejtpërdrejta midis konkurrentëve politikë, veçanërisht mes përfaqësuesve të pozitës dhe opozitës. Ky element mund të konsiderohet si një vakum në spektrin e përballjeve publike, që ndikon në pasqyrimin e plotë të pikëpamjeve politike për qytetarët.

DnV rritet rëndësinë e zhvillimit të debateve mbi temat programore dhe politike si një formë e ballafaqimit të platformave mes subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre. Kjo do të kontribuonte në rritjen e transparencës dhe do të ndihmonte qytetarët në formimin e një vendimi të informuar përpara votimit.

Një tjetër shqetësim që është evidentuar është qasja më e kufizuar e kryeministrit aktual dhe disa përfaqësuesve të partisë në pushtet në media. Për më tepër, është raportuar për thirrje publike nga kjo parti që disa media të bojkotohen, ndërsa janë ngritur dyshime për një vendim të mundshëm për bojkotimin e disa televizioneve kombëtare. Këto zhvillime, ndonëse të pa konfirmuara plotësisht, mund të ndikojnë në perceptimin e qytetarëve për barazinë e qasjes mediale.

Në përmbledhje, ndërsa media ka luajtur një rol kyç në mbulimin e fushatës dhe ka ofruar hapësira të konsiderueshme për informim, disa çështje si mungesa e debateve direkte dhe qasja e kufizuar e disa kandidatëve në media kërkojnë vëmendje për të siguruar përmbushjen e plotë të këtij standardi.

Sa i përket informimit të qytetarëve mbi aktivitetet e fushatës, Facebook vazhdon të jetë platforma kryesore e përdorur nga kandidatët për promovimin e aktiviteteve të tyre. Nga të dhënat e mbledhura përgjatë periudhës 1 shtator deri më 31 dhjetor 2024, kandidati për kryeministër nga subjekti politik LDK, Lumir Abdixhiku, ka pasur numrin më të madh të postimeve me gjithsej **172 postime**. Prej tyre, vetëm 101 postime janë shpërndarë edhe në Instagram. Shikuar nga përmbajtja e postimeve, 55 prej tyre i referohen takimeve me qytetarë, me biznese, të rinj dhe gra.

Kandidati për kryeministër nga radhët e PDK-së, Bedri Hamza, gjatë kësaj periudhe ka pasur gjithsej 131 postime. Prej tyre 120 postime janë publikuar edhe në Instagram, ndërsa në platformën X vetëm 14. Sa i përket përmbajtjes së postimeve 74 nga to kanë qenë postime mbi takime me grupe të ndryshme. 43 postime janë nga takimet me qytetarë, ndërsa një pjesë e postimeve janë nga takimet me biznese, të rinj dhe sindikata.

Kandidati për kryeministër nga Koalicioni AAK/NISMA/LK/E30, Ramush Haradinaj, gjatë kësaj periudhe ka pasur gjithsej 124 postime. Prej tyre 68 postime janë publikuar edhe në Instagram. Sa i përket përmbajtjes së postimeve 56 nga to kanë qenë postime mbi takime me grupe të ndryshme, përfshirë bizneset

17 postime janë nga prezantimi i kandidatëve për deputet, 14 nga takime me qytetar, 9 nga takime me biznese.

Kandidati për kryeministër nga LVV, Albin Kurti, gjatë kësaj periudhe ka pasur gjithsej 107 postime. Prej tyre 47 janë publikuar edhe në Instagram, ndërsa në platformën X vetëm 3 prej tyre. Sa i përket përmbajtjes së postimeve 53 nga to kanë qenë postime mbi takime me grupe të ndryshme. Në rastin e kryeministrit aktual vërehet një numër i madh i postimeve mbi përrurimet e objekteve (14 postime).

Përfshirja e grupeve të marginalizuara

- *Promovimi i një fushate gjithëpërfshirëse*
- *Pjesëmarrje e grave, të rinjve dhe grupeve të tjera të marginalizuara si kandidatë dhe votues*

pse fushata zgjedhore nuk ka shfaqur një fokus të theksuar mbi temat që adresojnë në mënyrë specifike nevojat e grupeve të marginalizuara, disa çështje si rritja e pensioneve, sporti dhe arsimit janë trajtuar pjesërisht, duke krijuar një hapësirë të kufizuar për diskutime. Subjektet politike kanë ndjekur një trend të përfshirjes së kandidatëve të rinj në listat e tyre, duke reflektuar një përpjekje për të përmirësuar përfaqësimin e gjeneratave të rinj.

Megjithatë, sa i përket përfaqësimit gjinor, partitë kryesisht janë kufizuar në përmbushjen e kërkesave ligjore për një minimum prej 30% për gjininë më pak të përfaqësuar. Kjo përqindje nuk është tejkaluar dukshëm dhe ka mbetur në nivele të ngjashme me zgjedhjet e kaluara, rreth 35%. Krijimi i listave kandiduese të modelit të barabartë gjinor ("zebra") ende mbetet një sfidë për partitë.

Në përgjithësi, pjesëmarrja e grupeve të marginalizuara si kandidatë dhe fokusi në çështjet e tyre mbetet i kufizuar, duke treguar nevojën për një qasje më gjithëpërfshirëse dhe proaktive në promovimin e barazisë dhe pjesëmarrjes së tyre efektive në jetën politike. Kjo tregon se përpjekjet për përfaqësim të barabartë dhe përfshirje të grupeve të marginalizuara janë më shumë një përmbushje formale sesa një angazhim strategjik për promovimin e barazisë.

Transparenca dhe Financimi i Fushatës

- *Financimi i fushatës duhet të jetë transparent dhe i bazuar në rregullat e sanksionuara me ligj.*
- *Raportimi financiar duhet të bëhet publik dhe të jetë i qasshëm për publikun.*

Financimi i fushatës zgjedhore po karakterizohet nga shpenzime të konsiderueshme në aktivitete vizuale dhe logjistike, duke përfshirë përgatitjen e sallave, skenave, banerëve, zërimin dhe ndriçimin për takime publike. Këto elemente kërkojnë një mbështetje të fortë financiare, duke reflektuar një angazhim të madh të partive në organizimin e aktiviteteve.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i shpenzimeve është angazhimi në marketingun digjital. Partitë po investojnë ndjeshëm në videografika, infografika dhe postime në rrjetet sociale për të rritur praninë e tyre online dhe për të arritur një audiencë më të gjerë. Sponsorizimet në Facebook dhe Instagram kanë shënuar një rritje të madhe dhe duket se janë një pjesë integrale e strategjisë së komunikimit të partive. Bazuar në sponsorizimet e dukshme deri tani, **LDK** kryeson në këtë drejtim, ndjekur nga **PDK**, **AAK**, dhe **VV** në vendin e katërt. Megjithatë, në javën e fundit, **VV** ka nisur një fushatë të fuqishme sponsorizimi, duke shënuar një ndryshim të dukshëm në angazhimin e saj financiar në rrjetet sociale.

Partitë dhe liderët politikë kanë ndjekur qasje të ndryshme për të maksimizuar ndikimin e tyre në audiencën online:

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK):

Me një shpenzim prej 36 mijë eurosh për 103 postime, LDK kryeson listën e investimeve në rrjetet sociale. Kryetari i partisë, Lumir Abdixhiku, ka shpenzuar veçmas 15 mijë euro për 88 postime, duke treguar një fokus të lartë në komunikimin direkt me qytetarët përmes rrjeteve sociale. **LDK dhe kandidati i saj për kryeministër kanë shpenzuar gjithsej 52 mijë euro në 191 postime.**

Partia Demokratike e Kosovës (PDK):

PDK ka ndjekur një qasje më të përmbajtur, me një shpenzim total prej vetëm 1,250 euro për 29 postime. Memli Krasniqi, lideri i PDK-së, ka shpenzuar 7 mijë euro për 115 postime, duke treguar një angazhim më të madh krahasuar me partinë. Ndërsa, një prej kandidatëve të kësaj partie (Betim Gjoshi) ka shpenzuar më shumë se vetë partia, me respektivisht rreth 1,500 euro për 34 postime, duke përforcuar mesazhet e partisë dhe përpjekjet individuale. Kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, ka investuar 5 mijë euro për 111 postime, duke ndjekur një strategji të balancuar midis frekuencës së postimeve dhe shpenzimeve financiare. **Faqja e PDK-së dhe kandidati i saj për kryeministër, kanë shpenzuar 6500 euro në rreth 150 postime.**

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK):

Ramush Haradinaj, lideri i AAK-së, ka shpenzuar 6 mijë euro për një numër të konsiderueshëm postimesh, plot 247 postime, duke ndjekur një strategji komunikimi të shpeshtë për të maksimizuar praninë e tij online.

Vetëvendosje (LVV):

LVV ka shpenzuar një shumë relativisht të ulët prej **3 mijë euro**, megjithatë shumica e këtyre shpenzimeve është realizuar gjatë javëve të fundit, duke treguar një angazhim të vonuar por të fuqishëm në platformat digjitale përmes 205 postimeve.

Me trendet e deritanishme të shpenzimeve, duket se kjo fushatë zgjedhore mund të rezultojë me një kosto të lartë financiare. Megjithatë, mbetet të shihet se cila do të jetë strategjia e partive politike në raport me mediat tradicionale, veçanërisht televizionet, gjatë periudhës zyrtare të fushatës zgjedhore. Sponsorimi i emisioneve, videove dhe reklamave pritet të jetë një tjetër komponent i rëndësishëm që mund të rrisë ndjeshëm koston e përgjithshme të kësaj fushate.

Publikimi i raportimeve financiare dhe transparenca e burimeve të financimit do të jenë thelbësore për të vlerësuar nëse shpenzimet e partive janë në përputhje me rregulloret dhe nëse mbeten brenda kufijve të etikës dhe llogaridhënies.

Përdorimi i Gjuhës së Drejtë dhe Jo Diskriminuese

- *Fushata duhet të shmangë gjuhën urrejtëse, diskriminuese ose nxitëse të dhunës.*
- *Kandidatët dhe partitë duhet të promovojnë respekt dhe dialog konstruktiv.*

Fushata zgjedhore deri më tani është zhvilluar në një kuadër që respekton standardet për ruajtjen e integritetit dhe dinjitetit të kundërshtarëve politikë. Në përgjithësi, periudha e parafushatës është karakterizuar nga një ton i qetë, me partitë dhe kandidatët që kanë shmangur përdorimin e gjuhës urrejtëse, diskriminuese apo nxitëse të dhunës, duke promovuar një dialog të përmbajtur dhe konstruktiv.

Në muajt e fundit, vihet re një emancipim i dukshëm në diskursin politik, ku përdorimi i epiteteve dhe sulmeve personale është minimizuar dukshëm. Kjo tregon një përpjekje për të përqendruar debatet në tema të rëndësishme dhe për të ofruar alternativa politike në vend të përshkallëzimit të gjuhës konfrontuese.

Megjithatë, mbetet të shihet nëse ky trend do të ruhet gjatë intensifikimit të fushatës, pasi shpeshherë fazat përfundimtare të garës politike kanë tendencë të sjellin retorikë më të ashpër. Ruajtja e gjuhës së drejtë dhe jo diskriminuese është thelbësore për të promovuar një klimë zgjedhore të qetë dhe gjithëpërfshirëse, duke forcuar besimin e qytetarëve në procesin demokratik.

Analizimi i rrjeteve sociale gjatë parafushatës ka gjetur se qytetarët kanë drejtuar komente me përmbajtje të gjuhës urrejtëse për kandidatët e subjekteve politike, përfshirë kandidatet gra. DnV ka përdorur platformën Pikasa për të monitoruar 152 portale online, ku janë identifikuar mbi **450,000** komente, **6%** e të cilave me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes drejtuar subjekteve politike. Për më tepër, gratë që kandidojnë për zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 janë përballur me gjuhë të urrejtjes në hapësirat online. Nga 107,000 komente të analizuar në rrjete sociale, 7,000 prej tyre (6%) janë identifikuar si gjuhë urrejtjeje.

Kandidatet më të sulmuara përfshijnë ato nga partitë si AAK, VV, LDK dhe PDK, përkatësisht Time Kadrijaj - AAK, (15% e komenteve me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes), Fitore Pacolli - LVV (14%), Hykmete Bajrami - AAK (10%), Adriana Matoshi – LVV (10%), Rozeta Hajdari – LVV (9%), dhe Eliza Hoxha – PDK (8%). Këto shifra reflektojnë një sfidë të rëndësishme për barazinë gjinore dhe etikën në politikë gjate parafushates.

Ndërsa nga 30,000 komente të përpunuara sa kanë marrë kandidatët për kryeministër në rrjetet sociale, gjuha e urrejtjes është shpërndarë në përqindje të ndryshme: Albin Kurti (7%), Bedri Hamza (6%), Lumir Abdixhiku (6%), dhe Ramush Haradinaj (4%).

Fjalët më të përdorura në këto diskutime janë “hajn,” “tradhtar,” “vjedh,” “kriminel,” dhe “analfabet,” duke nxjerrë në pah natyrën polarizuese të debatit publik.

Neutraliteti Institucional

- *Organet e sigurisë dhe agjencitë tjera shtetërore duhet të ruajnë neutralitetin institucional.*

Neutraliteti i institucioneve shtetërore, veçanërisht i organeve të sigurisë, është thelbësor për të garantuar një proces zgjedhor të drejtë dhe të paanshëm. Deri më tani, institucionet e sigurisë dhe agjencitë shtetërore janë shquar për profesionalizëm dhe ruajtjen e neutralitetit partiak, duke siguruar një mjedis të qetë dhe të sigurt për mbajtjen e tubimeve dhe takimeve publike, si dhe për sigurinë e liderëve politikë dhe qeveritarë.

Megjithatë, janë raportuar disa raste që kanë ngritur shqetësime lidhur me ruajtjen e këtij neutraliteti. Në ditët e fundit, janë vërejtur tre pjesëtarë të policisë, disa prej të cilëve ishin jashtë orarit të punës, duke marrë pjesë në takime politike të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Pas shpërndarjes së videove dhe fotografive të këtyre rasteve në rrjetet sociale, Inspektorati Policor i Kosovës ka ndër marrë veprime të menjëhershme, duke pezulluar nga puna këta zyrtarë policorë deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga organet kompetente.

Ky reagim tregon përkushtimin e institucioneve për të mbajtur një standard të lartë të paanshmërisë dhe për të adresuar me seriozitet çdo devijim të mundshëm. Vazhdimi i monitorimit dhe reagimit të tillë mbetet kyç për të siguruar besimin e qytetarëve dhe palëve të përfshira në integritetin e procesit zgjedhor dhe të institucioneve shtetërore.

Qartësia dhe Informimi i Votuesve

- *Votuesit duhet të kenë qasje në informacion të qartë për procedurat dhe afatet kohore për të votuar.*

Një nga aspektet kyçe për zgjedhje të drejta dhe gjithëpërfshirëse është sigurimi i qasjes së votuesve në informacion të qartë dhe të saktë për kandidatët, partitë politike dhe programet e tyre. Për më tepër, edukimi zgjedhor duhet të jetë i balancuar dhe jo i njëanshëm, duke i mundësuar çdo qytetari të kuptojë plotësisht procesin zgjedhor dhe të ushtrijë të drejtën e tij në mënyrë të informuar.

Në Kosovë, një numër i madh i votave të pavlefshme është vërejtur në shumë procese zgjedhore të kaluara, duke theksuar nevojën për një edukim më efektiv të votuesve. Me ndryshimet e fundit në procedurat e votimit, kjo sfidë bëhet edhe më e rëndësishme. Ndërsa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka nisur një dinamikë fillestare për të informuar qytetarët për të drejtat e tyre, vendvotimet, qendrat e votimit, procedurat dhe afatet kohore, deri tani mungon një fushatë mediale më gjithëpërfshirëse, kreative dhe tërheqëse. Një qasje më agresive dhe inovative në komunikim është e nevojshme për të kapur vëmendjen e votuesve, veçanërisht të rinjve dhe grupeve që zakonisht tregojnë interes më të ulët për procesin zgjedhor.

Për të rritur përfshirjen dhe për të reduktuar votat e pavlefshme, është e rëndësishme që KQZ të zhvillojë një strategji më të strukturuar dhe të fuqishme për edukimin zgjedhor, duke përdorur mjetet moderne të komunikimit dhe platformat digjitale për të arritur një audiencë sa më të gjerë.

Administrimi i zgjedhjeve

Gjatë periudhës së certifikimit të Srpska Lista, janë raportuar raste të sulmeve verbale ndaj Kryetares së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të kryera nga disa zyrtarë të partisë në pushtet, përfshirë zëvendësministrin e Drejtësisë. Këto sulme kanë krijuar një presion të panevojshëm ndaj një organi kushtetues që ka si mandat garantimin e një procesi zgjedhor të drejtë dhe të paanshëm.

Sipas standardeve ndërkombëtare, pavarësia dhe integriteti i organeve zgjedhore janë elemente kyçe për zgjedhje demokratike. Sulmet ndaj Kryetares së KQZ-së minojnë besimin e publikut në një proces të paanshëm zgjedhor dhe krijojnë pengesa në përmbushjen e mandatit të institucionit. DnV dënon këto sulme dhe bën thirrje për respekt ndaj pavarësisë institucionale të KQZ-së.

Lista e votuesve dhe sfidat në mirëmbajtjen e saj

Lista e votuesve e certifikuar nga KQZ për zgjedhjet e ardhshme përfshin 2,075,868 votues, duke përfshirë 125,852 votues për herë të parë. Gjithashtu, lista përfshin 104,924 votues të regjistruar për votim jashtë vendit, përmes metodave të ndryshme:

- 67,404 votues përmes votimit postar nga misionet diplomatike.
- 20,416 votues përmes votimit fizik në misionet diplomatike.
- 17,104 votues përmes postës direkt në Kosovë.

Numri i përgjithshëm i votuesve duket të jetë në disproporcion me regjistrimin e fundit të popullsisë, si pasojë e:

- Mungesës së veprimeve adekuate nga institucionet për të siguruar një listë votuesish të pastër.
- Metodologjisë së përdorur për përpilimin e listës.
- Përfshirjes së qindra mijëra qytetarëve që kanë dokumente të Kosovës, por nuk jetojnë në vend.
- Mungesës së heqjes nga lista të personave të vdekur, pavarësisht përpjekjeve të KQZ-së për përmirësimin e saj.

Votimi jashtë vendit

Votimi përmes postës nga misionet diplomatike mbetet opsioni më i preferuar, i zgjedhur nga rreth 70% e votuesve jashtë vendit. Periudha prej 30 ditësh në dispozicion të votuesve është e mjaftueshme për të shmangur vonesat dhe problemet që kanë ndodhur në të kaluarën, duke garantuar një proces më të rregullt votimi.

Për votimin fizik, i zgjedhur nga 20,416 votues, janë vërejtur disa sfida, veçanërisht në vendet me interes të lartë si Gjermania dhe Zvicra. Në disa misione diplomatike, numri i votuesve të regjistruar po afrohet kapacitetit maksimal prej 1,000 votues për vendvotim. Këto situata mund të krijojnë vështirësi në administrimin e procesit të votimit gjatë ditës së zgjedhjeve.

Disa prej qendrave më të ngarkuara përfshijnë:

- Vjenë: 941 nga 1,000 votues maksimalisht.
- Zyrih: 1,953 nga 2,000 votues maksimalisht.
- Diseldorf: 2,015 nga 3,000 votues maksimalisht.
- Frankfurt: 1,567 nga 2,000 votues maksimalisht.
- Gjenevë: 981 nga 1,000 votues maksimalisht.
- Mynih: 1,972 nga 2,000 votues maksimalisht.
- Shtutgart: 1,970 nga 2,000 votues maksimalisht.

Ndërkohë, disa qendra janë mbyllur për shkak të interesit të ulët, si në Tiranë dhe Podgoricë.

Sipas standardeve ndërkombëtare, listat e votuesve duhet të jenë të sakta, të pastra dhe të mirëmbajtura në mënyrë transparente. Në këtë rast, përfshirja e votuesve që nuk jetojnë në Kosovë ose të personave të vdekur e cenon integritetin e procesit zgjedhor.

Për sa i përket votimit jashtë vendit, ofrimi i periudhës prej 30 ditësh për votimin postar është një hap pozitiv drejt lehtësimit të pjesëmarrjes.

REKOMANDIME

DnV inkurajon të gjitha subjektet politike pjesëmarrëse në garë zgjedhore:

- **Të kontribuojnë në një fushatë përmbajtësore** duke promovuar një diskurs programor, duke marrë pjesë në debate e takime, duke i ballafaquar programet e tyre politike dhe duke informuar votuesit për ofertat e tyre politike
- **Të angazhohen në diskutime me votueset gra por edhe grupet tjera specifike** – përmes një qasje proaktive për të përfshirë gratë, të rinjtë dhe grupet e marginalizuara si kandidatë dhe të fokusohen në temat që adresojnë nevojat e tyre. Përfaqësimi gjinor duhet të tejkalojë kërkesat minimale ligjore, duke promovuar barazinë dhe gjithëpërfshirjen.
- **Të përmbahen nga gjuha diskriminuese** – duke iu përmbajtur një diskursi konstruktiv dhe që shmangë përdorimin e gjuhës urrejtëse, duke krijuar një atmosferë zgjedhore të qetë dhe respektuese.
- **Të jenë transparente në shpenzimet e tyre për aktivitetet e fushatës** – duke siguruar raportime të plota dhe transparente mbi shpenzimet e fushatës, përfshirë sponsorizimet në mediat digjitale. Raportet duhet të jenë lehtësisht të qasshme për publikun, duke forcuar besimin e qytetarëve në integritetin e proceseve financiare.

DnV inkurajon qytetarët dhe votuesit, që:

- Të jenë më kërkues dhe të marrin pjesë në **diskutimet për ofertat programore**, duke u informuar mbi platformat politike dhe kandidatët, duke përdorur burime të besueshme informacioni. Kjo do t'i ndihmojë votuesit që të marrin vendime të informuara dhe në përputhje me prioritetet e tyre.

Për institucionet dhe akterët tjerë relevant, DnV:

- Kërkon të **monitorojnë përdorimin e resurseve publike për qëllime elektorale**, duke u siguruar që burimet shtetërore të mos përdoren për qëllime elektorale. Çdo rast i abuzimit të burimeve duhet të hetohet dhe të ndiqet ligjërisht për të siguruar garë të barabartë.
- **Institucionet shtetërore dhe organet e sigurisë duhet të mbeten të paanshme** dhe të ruajnë profesionalizmin e tyre gjatë gjithë procesit zgjedhor, duke shmangur çdo përfshirje direkte apo indirekte në aktivitetet politike.
- KQZ duhet të zhvillojë **fushata informuese dhe edukuese** më gjithëpërfshirëse dhe kreative për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi procedurat e votimit dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së informuar. Përdorimi i platformave digjitale dhe mjeteve interaktive është thelbësor për të arritur votuesit, sidomos të rinjtë.
- KQZ-ja duhet të përmbahet nga **trajtimi politik i çështjeve të rregulluara me ligj**, përfshirë certifikimin e subjekteve politike, si dhe ndarjen e mjeteve të parapara nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike.
- Ofruesit e shërbimeve mediale (televizionet dhe radiot) të bëjnë publike një javë para fushatës zgjedhore **orarin me shkrim të kohës së emitimit me dhe pa pagesë** për reklamat e subjekteve politike, sasinë e kohës së shitur dhe çmimet e ofertuara.